

P. nr.457/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.K. nga Gjykata për shkak të veprës penale të rrezikimit të trafikut publik ë nga neni 378/6-1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP.nr.297/16 të datës 04.08.2016, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur më datë **19.12.2016**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj dhe të akuzuarit F.K. të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **F.K.**, i biri i I. dhe i nënës B. e gjinisë Sh., i lindur me dt... ne Gjakovë, Rr"Y.e E" nr.8, ka te kryer shkollën mesëm, i pa punë, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i divorcuar at i 2 fëmijëve.

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse :

-me dt.15.07.2016, rreth orës 10.30 min, në rrugën "Tirana" saktësisht afër stacionit të autobusëve në Gjakovë, rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 54 dhe nenin 126 lidhur me nenin 352 të LSKRR-es dhe ve në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtareve të markës "VW Passat", me targa të regjistrimit ... me ngjyre të kaltër, duke mos ia përshtatur shpejtësinë e lëvizjes rrethanave dhe kushteve në rrugë, si dhe duke mos e mbajtur distancën e nevojshme të sigurisë me automjetin para tij, ku si pasojë me pjesën e përparmë të automjetit të tij e godet në pjesën e pasme të automjetit para tij të markës "Peugeot 206", me targa të regjistrimit... me ngjyre të verdhë, të cilën e drejtonte A.N. me ç'rast përpos dëmeve materiale në automjete të dëmtuara A.N. si dhe bashkudhëtari i saj R.N. pësojnë lëndime të lehta trupore të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko- ligjore të dt. 03.08.2016, nga eksperti mjeko- ligjore Dr. F.D.

-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6/1 të KPRK-së.

Gjykata në mbështetje të nenit 4, 41, 49, 50, 51, 52, 73 dhe nenit 378/6-1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej **3(tre)muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë në shumë prej **60.88euro** si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **20 euro**, e këtë në afatin prej **15 ditësh** pasi që aktgjykimi të merr formë të prere nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.297/16 të dt.04.08.2016,e ka akuzuar të akuzuarin F.K. nga Gjakova , për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6-1 të KPRK-së, duke propozuar që ndaj të akuzuarit ti shqiptohet Urdhër ndëshkimor, me të cilën do ti shqiptohet dënimi me gjobë. Gjykata ka aprovuar Propozimin e Prokurorisë Themelore dhe me Aktgjykim me P.nr.457/16 të dt.04.08.2016, të akuzuarin e ka shpallur përgjegjës dhe i ka dënuar me gjobë ne shume prej nga 200 ,oo.-Euro , si dhe i ka obliguar që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 60.88 Euro dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga 30,oo euro. I akuzuari F.K. në afatin ligjor ka parashtruar kundërshtim kundër këtij Aktgjykimi , dhe për këtë arsye pranë kësaj Gjykate u mbajt shqyrtimi gjyqësor.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor publik të datës19.12.2016, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë, Prokurori Ismet Tofaj lexon aktakuzën PP.nr.297/16 të dt.04.08. me ç ‘rast prokurori deklaroi se mbetet në tersi pranë aktakuzës. Në fjalën përfundimtare deklaroi se me pranimin e fajësisë nga i akuzuari e qe u be i lirshëm e vullnetshëm duke i kuptuar pasojat u vërtetu mjaftë edhe pse nga shkresat e lendes ka edhe prova tjera bindëse se ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/6-1 te KPRK-ës , e gjykatës i propozoi qe te njëjtin ta shpall fajtor për shkallen e përgjegjësisë penale te ta dënoi sipas ligjit dhe ta detyroi ne pagesën e shpenzimeve te procedurës.

I akuzuari F.K. gjatës shqyrtimit gjyqësor duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion .Në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer nga pakujdesia për çka i kërkojë falje nga të dëmtuarit për demin e shkaktuar, premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe do te jem me i kujdesshëm, andaj i propozoi gjykatës qe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, gjendjen e varfër ekonomike, si dhe faktin se asnjëherë me pare nuk kam qene i dënuar nga ana e gjykatës te me shqiptohet një dënim me i butë.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 te KPPK-së, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Gjykata ka konstatuar se i akuzuari ka bërë shkelje të dispozitës se nenit 54,126 lidhur me nenin 352 te Ligjit për Siguri ne Komunikacionin Rrugor, siç është përshkruar ne dispozitivin e këtij aktgjykimi, kështu qe nga ky aksident përpos dëmeve materiale në automjete e dëmtuara A. N. dhe bashkudhëtari i saj R.N. pësojnë lëndime të lehta trupore , të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të dt. 03.08.2016 nga eksperti Dr. F.S. me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni378/6-1 të KPRK-ës.

Me rastin e matjes së dënimit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, pendimin e tij të shprehur për veprën e kryer duke kërkuar falje publike para gjykatës nga te dëmtuarit, gjendjen e varfër ekonomike, si faktin se i akuzuari më parë nuk ka qenë i dënuar, të cilat rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-së, Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili

dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit prej 1(një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale , me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesë pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463/2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mirëkonform nënitet 450/2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-ës .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 457/16 me datë 19.12.2016.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim ,Gjykatë së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate